

MASTER

NË ADMINISTRIM BIZNESI

Me profil në
TË DREJTË BIZNESI

**NDËRTO KARRIERËN TËNDE
NË NDËRTHURJEN MES
LIGJIT DHE BIZNESIT PËR
TË UDHËHEQUR ME KOMPETENCË!**

Kohëzgjatja: **24 muaj**
Gjuha: **Shqip**
Vendodhja: **Tiranë**

Skano
për më
shumë
info



MESAZHI I DREJTUESIT AKADEMIK TË PROGRAMIT



“Të dashur studentë,
Programi i Masterit në të drejtë biznesi është
ndërtuar me kujdes për të ofruar një ndër-
thurje të balancuar midis njohurive juridike
dhe atyre të menaxhimit të biznesit. Kurrikula
përfshin jo vetëm fushat kyçe të së drejtës
dhe ekonomisë, por edhe zhvillimin e aftësive

të buta si mendimi kritik, zgjidhja e problemeve dhe
inovacioni të domosdoshme për sukses në një treg
gjithnjë e më dinamik dhe global.

Me anë të këtij programi synojmë të formojmë liderët e
së ardhmes në fushën e biznesit, duke ju ofruar jo vetëm
mësimdhënie nga profesorë dhe ekspertët më të njohur,
por edhe një fokus të veçantë në përvojën praktike.

Përmes partneriteteve me kompani të njohura si Grupi BALFIN, institucione publike,
organizata biznesi dhe zyra ligjore, studentët tanë do të kenë mundësinë të aplikojnë
njohuritë e fituara në situata reale, duke u përgatitur në mënyrë efektive për sfidat e
tregut të punës.

Për sa me sipër, jemi te bindur që ky udhëtim akademik do t'ju pajisë me mjetet e
duhura dhe do t'ju bëjë më të aftë për tu përballuar sfidat komplekse të botës moderne
të biznesit.”

Dr. Lorenc Gordani

Drejtuesi Akademik i Masterit në të Drejtë Biznesi


PËRMBLEDHJE E PROGRAMIT

Ky Master ofron një përvojë formuese unike, duke ndërthur ekspertizën juridike me
aftësitë menaxheriale në përgatitjen e profesionistëve të aftë për tu përballuar me sfidat
ligjore të korporatave dhe sipërmarrjet në nivele kombëtare dhe ndërkombëtare. Pro-
grami përgatit liderë të suksesshëm në fushën e së drejtës së biznesit, duke i pajisur
pjesëmarrësit me njohuri dhe kompetenca për t'u angazhuar me profesionalizëm në një
ambient gjithnjë e më konkurrues dhe përshtatet me dinamikën e tregut dhe kërkesat e
vazhdueshme të industrisë.

PËRFITIMET

Programi ofron një platformë unike zhvillimi personal dhe profesional për të ndërtuar një profil të kompletuar lideri që kombinon të drejtën dhe menaxhimin.

Disa prej përfitimeve kryesore përfshijnë:



PERSPEKTIVAT E PUNËSIMI TË HAPURA NGA MASTERI NË TË DREJTË BIZNESI:

Ky program hap dyer karriere konkrete, si në sektorin privat ashtu edhe në atë publik, si në vend edhe jashtë. Të diplomuarit mund të angazhohen në role që kërkojnë njohuri të thelluara juridike dhe aftësi të forta menaxheriale, si:

- Sipërmarrës dhe themelues biznesi
- Menaxher i Zhvillimit të Biznesit
- Konsulent Ligjor për korporata dhe biznese
- Përfaqësues Ligjor në institucione vendase apo ndërkombëtare
- Këshilltar i çështjeve të qeverisjes korporative
- Konsulent për tregje ndërkombëtare dhe bashkëpunime ndërkufitare
- Avokat në fushën e së drejtës tregtare, tatimore apo kontraktuale
- Këshilltar për politika ekonomike dhe zhvillim të qëndrueshëm
- Drejtor i Departamenteve Ligjore në kompani ose institucion

PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Programi i Masterit në Administrim Biznesi, me profil në të Drejtë Biznesi, ofron një kurrikul të integruar prej 120 kredite ECTS, të ndërtuar për të zhvilluar kompetenca të thelluara juridike dhe menaxheriale që nevojiten për drejtimin dhe menaxhimin efikas dhe përputhshmëri ligjore të bizneseve.

Struktura e programit përfshin 8 lëndë gjatë vitit të parë dhe 7 lëndë në vitin e dytë, ndërsa pjesa tjetër e krediteve fitohet përmes praktikës profesionale dhe provimit të diplomimit.

Më poshtë, po ju paraqesim një përshkrim të grupeve të lëndëve të organizuara sipas fushave kryesore që programi mbulon:

1 | LIDERSHIP, QEVERISJE E KORPORATAVE DHE MARRËDHËNIET E PUNËS

Qeverisja e Korporatave mëson si të zbatoni korniza të strukturuar menaxhuese, ndërsa Sjellja Organizative dhe Liderhipi ndihmon në përmirësimin e aftësive për menaxhimin e dinamikave të brendshme. E Drejta në Marrëdhëniet e Punës pajis pjesëmarrësit me njohuri mbi bazat ligjore të marrëdhënieve punëdhënës–punëmarrës. Ndërkohë, Praktika Profesionale shërben si një lidhje e drejtpërdrejtë midis teorisë dhe përvojës konkrete, duke përgatitur studentët për sfidat reale të mjedisit të punës.

2 | MENAXHIM DHE VENDIMMARRJE STRATEGJIKE

Ky modul lëndësh ndihmon në zhvillimin e aftësive menaxheriale thelbësore përmes një qasjeje të integruar, që përfshin menaxhimin strategjik, menaxhimin e projekteve, vlerësimin dhe sistemet e informacionit. Ai fokusohet në vendimmarrjen efektive dhe zhvillimin e aftësive të avancuara në këto fusha, duke i përgatitur studentët të analizojnë mjedisin, të planifikojnë dhe kontrollojnë projekte, të vlerësojnë suksesin e tyre dhe të rrisin efikasitetin përmes përdorimit të teknologjisë. Moduli përmbyllet me një integrim praktik të njohurive të fituara, duke i ndihmuar studentët të zgjidhin probleme reale dhe komplekse në fushën e menaxhimit.

3 | FINANCAT, TAKSAT DHE KUADRI NORMATIV I BIZNESIT

Ky modul ofron një kuptim të thellë të legjislacionit financiar dhe menaxhimit të burimeve financiare, të cilat janë thelbësore për vendimmarrjen strategjike në biznesit. Ai mbulon Drejtimin Financiar të Avancuar, Taksimin e Biznesit, si dhe kuadrin ligjor që lidhet me të Drejtën Bankare dhe Financiare. Përmes këtyre fushave, studentët aftësohen të analizojnë dhe menaxhojnë risqet financiare, duke garantuar përputhshmëri me ligjet dhe përmirësuar performancën financiare të organizatave.

4 | KUADRI LIGJOR DHE STRATEGJIK PËR ZHVILLIMIN E BIZNESIT

Ky modul, ndër më të rëndësishmit në program, ofron një kuptim të thelluar të kuadrin ligjor dhe rregullator që mbështet funksionimin dhe zhvillimin e aktiviteteve të biznesit. Ai trajton tema kyçe si Mjedisi Rregullator i Biznesit, E Drejta e Biznesit e Avancuar, E Drejta e Kontratave Tregtare, si dhe Arbitrazhi dhe Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve. Studentët pajisen me aftësi për të identifikuar dhe menaxhuar risqet ligjore, duke siguruar që ndërmarrjet të operojnë në përputhje të plotë me kuadrin ligjor. Këto njohuri janë thelbësore për të mbështetur një zhvillim të qëndrueshëm dhe të suksesshëm të organizatave në një mjedis kompleks dhe të rregulluar.

AFTËSITË E ZHVILLIMIT PERSONAL DHE NDËRPERSONAL

1. **Mendimi Kritik:** Aftësia për të vlerësuar situata dhe informacione nga këndvështrime të ndryshme për të marrë vendime të informuara.
2. **Zgjidhja e Problemeve:** Aftësia për të analizuar dhe zgjidhur probleme komplekse që ndodhin në ndërveprimin mes sektorëve të ndryshëm, duke gjetur zgjidhje inovative.
3. **Adaptueshmëria:** Aftësia për t'u përshtatur me ndryshimet dhe për të menaxhuar sfidat që lindin nga bashkëpunimi ndërmjet sektorëve të ndryshëm.
4. **Menaxhimi i Kohës dhe Prioriteteve:** Aftësia për të organizuar detyrat dhe prioritetet për të përmbushur afatet dhe qëllimet në një mjedis shumësektorial.
5. **Menaxhimi i Projekteve:** Aftësia për të projektuar, zbatuar dhe ndjekur projekte komplekse që përfshijnë bashkëpunimin ndërdisiplinor dhe ndërinstitutional.
6. **Lideriship:** Aftësia për të udhëhequr dhe motivuar ekipe të ndryshme për të arritur objektiva të përbashkët dhe për të krijuar një atmosferë bashkëpunuese.

METODA E MËSIMDHËNIES

Mësimi në këtë program nuk ndalet vetëm te teoria. Ai ndërthur përvojën reale në terren me qasje interaktive dhe bashkëpunim të ngushtë me industrinë. Metodologjia e mësimdhënies është e dizajnuar për të zhvilluar njohuritë dhe aftësitë praktike të studentëve, përmes kombinimit të teknikave të ndryshme bashkëkohore.

Disa nga metodat kryesore përfshijnë:

1

LEKSIONET DHE DISKUTIMET:

Prezantimi i teorisë dhe koncepteve kryesore përmes ligjëratave dhe diskutimeve mbi kuadrin ligjor dhe rregullator, duke theksuar aspekte praktike.

2

SEMINARET DHE HULUMTIMI:

Seminaret dhe pjesëmarrja në projekte kërkimore që përfshijnë diskutime mbi tema specifike, shpesh të drejtuara nga profesionistë të fushës i ndihmon studentët të zhvillojnë aftësi analitike dhe kritike.

3

STUDIMI I RASTEVE DHE SIMULIMET:

Analizimi i rasteve reale dhe simulimet e situatave të biznesit ndihmojnë studentët të aplikojnë njohuritë dhe të zhvillojnë aftësi si mendimi kritik dhe zgjidhja e problemeve.



4

**GRUPET E DISKUTIMIT
DHE PROJEKTET:**

Puna në grupe nxit bashkëpunimin, komunikimin efektiv dhe aftësitë për menaxhimin e dinamikave të ekipit.

5

**PROJEKTE DHE PUNË
PRAKTIKE:**

Përfshirja e studentëve në projekte ose praktikë në institucione dhe kompani reale i ndihmon ata të lidhin teorinë me zbatimin në terren.

6

**E-LEARNING DHE
REFLEKTIMI:**

Përdorimi i teknologjisë dhe procesi i reflektimit mbi përvojat e tyre siguron përmirësim të vazhdueshëm të aftësive personale dhe profesionale.

Kombinimi i këtyre metodave siguron një përvojë të plotë dhe gjithëpërfshirëse studimi, duke i përgatitur studentët në mënyrë të gjithanshme për sfidat e karrierës në të drejtën e biznesit.

PROGRAMI “E DREJTË BIZNESI”

Program i masterit 2-vjeçar në të Drejtë Biznesi përfshinë njohuri themelore dhe të avancuara e praktike:



VITI I PARË

Semestri 1: Hapat e pare në të Drejtë Biznesi

Nr.	Lënda	Lektorët	Kredite
1	Sjellje Organizative dhe Liderhip	Elida Motro (Iljazi) PhD Ani Mbrica, PhD	6
2	Mjedisi Rregullator i Biznesit	Lorenc Gordani, PhD Afrim Osmani, Dr. (c)	6
3	Taksim Biznesi	Abaz Aliko, Dr. Maela Alicanaj, Magjister	6
4	E Drejta e Kontratave Tregtare	Lorenc Gordani, PhD Albana Misja, Magjister	6
5	Menaxhimi i Sistemeve të Informacionit të Avancuar	Indrit Baholli, Prof. Asoc. Dr.	6

Semestri 2: Avancim në Kuadrin Ligjor dhe Qeverisjen e Biznesit

Nr.	Lënda	Lektorët	Kredite
1	Menaxhim Strategjik	Vasilika Kume, Prof. Dr.	6
2	E Drejte Biznesi e Avancuar	Lorenc Gordani, PhD Endri Papajorgji, Prof. Dr.	6

3	Qeverisja e Korporatave	Rezart Dibra, Prof. Asoc. Dr.	6
4	E Drejta Bankare dhe Financiare	Elvin Meka, Prof. Dr. Enik Pogaçe, LLM	6
5	E Drejta në Marrëdhëniet e Punës	Lorenc Gordani, PhD	6

VITI I DYTË

Semestri 3: Menaxhim i Projekteve dhe Drejtim Financiar

Nr.	Lënda	Lektorët	Kredite
1	Menaxhim Projektesh	Elona Garo, Dr.	6
2	Drejtim Financiar i Avancuar	Abaz Aliko, Dr.	6
3	Vlerësimi Projekteve	Ani Mbrica, PhD Miranda Misini, MSc	6
4	E Drejta Fiskale dhe e Krahasuar	Abaz Aliko, Dr. Maela Alicanaj, Magjister	6
5	Arbitrazhi dhe Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve	Albana Misja, Magjister	6

Semestri 4: Praktika dhe Finalizimi i Studimeve

Nr.	Lënda	Lektorët	Kredite
1	Praktikë Profesionale dhe Raporti i Përvojës Profesionale	Komision	12
2	Temë Diplome/ Provimi i Përgjithshëm Përfundimtar	Komision	18

MASTER NË ADMINISTRIM BIZNESI ME PROFIL NË TË DREJTË BIZNESI

Kohëzgjatja:

2 vite akademike (4 semestra)

Forma e studimit:

Me kohë të plotë

Gjuha:

Shqip

NA KONTAKTONI:

☎ +355 69 70 66 966

✉ info@tbu.edu.al

🌐 www.tbu.edu.al

📍 Rruga Rezervat e Shtetit,
Lundër, Tiranë, Shqipëri

DIPLOMA MASTER PROFESIONAL
NË ADMINISTRIM BIZNESI
ME PROFIL NË TË DREJTË BIZNESI
ME 120 ECTS

KRITERET E PRANIMIT:

- Diplomë e nivelit Bachelor;
- CV;
- Letër Motivimi;
- Dokument Identifikimi.